



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:294952

Datë: 18.05.2021

Numri i dokumentit: 01787523

C.nr. 679/2019

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini me bashkëpunëtorin profesional Adnan Hajdari, në çështjen kontestimore të paditëses N.N nga fshati Pozheran, Komuna e Vitisë, të cilën me autorizim e përfaqëson, Liman Musa, avokat nga Ferizaji, Rr. “Driton Islami” p.nr., kundër të paditurës Komuna e Vitisë - DKA, të cilën me autorizim e përfaqëson, Ekrem Shabani, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 1, 917 Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 07.05.2021, jashtë seance, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.N nga fshati Pozheran, Komuna e Vitisë, e paraqitur kundër të paditurës Komuna e Vitisë - DKA dhe, detyrohet e paditura, që paditëses, në emër të shpërblimit jubilar, për 10 vite të përvojës së punës, t’ia kompensoj 50% të një page bazë, respektivisht shumën prej 210.50 Euro, ndërsa, në emër të ushqimit ditorë, për periudhën 18.04.2017 deri më 17.04.2021, për 475 ditë të pranisë në punë në SHFMU “Halil Alidema” në fshatin Pozheran, t’ia kompensoj dy euro në ditë, respektivisht shumën prej 950 Euro, ndërsa për periudhën 18.04.2017 deri më 30.06.2018, për 206 ditë pune, në SHFMU “Njazi Rexhepi” në fshatin N.N, t’ia kompensoj dy euro në ditë, respektivisht shumën prej 412 Euro, dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 30.06.2018, për 266 ditë pune, t’ia kompensoj 70% të biletës së trafikut urban, në vlerë prej 186 Euro, e të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 1, 548 Euro, me kamatë prej 8% në vit, nga data e parashtrimit të padisë deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditëve, nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. Refuzohet si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë për shpërblimin jubilar dhe për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit përtej shumës gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

III. Detyrohet e paditura që paditëses t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270 Euro.

IV. Detyrohet paditësja që t’ia paguaj gjykatës taksën shtesë për padi, në shume prej 10 Euro, në afat prej 7 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja N.N nga fshati Pozheran Komuna e Vitisë, përmes përfaqësuesit së saj me autorizim, me padinë e datës 20.12.2019 dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga Gjykata, t’ia

aprovojë kërkesëpadinë ashtu që në emër të shpërblimit jubilar për 10 vite të përvojës së punës t'ia paguaj 50% të një page bazë, respektivisht shumë prej 223 Euro, ndërsa, për shpenzime të ushqimit ditorë nga 2 Euro në ditë, për 488 ditë pune, të llogaritur nga data 18.04.2017 deri më 06.05.2021, në SHFMU "Halil Alidema" në fshatin Pozheran, ndërsa për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 30.06.2021, 206 ditë pune në SHFMU "Njazi Rexhepi", shumë prej 1, 508 Euro, ndërsa për shpenzime të udhëtimit, për në vendin e punës në SHFMU "Njazi Rexhepi" në fshatin N.N, për periudhën nga data 18.04.2017, deri më 30.06.2018, për 266 ditë pune, t'ia kompensoj 70% të çmimit të biletës së trafikut urban, në vlerë prej 186 Euro, të gjitha në shumë të përgjithshme prej 1, 917 Euro, me kamatë prej 8% nga data e parashtrimit të padisë, deri në pagesën përfundimtare.

Bazën ligjore të kërkesëpadisë, paditësja e mbështeti në nenin 35, par.5, 7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, për shkak se është në marrëdhënie pune në SHFMU "Halil Alidema" në Pozheran, dhe përkundër parashtrimit të kërkesës para fillimit të procesit kontestimor, e paditura nuk ia ka kompensuar paditësës shpërblimin jubilar, shpenzimet e ushqimit ditorë dhe udhëtimit, të cilat i takojnë sipas Kontratës Kolektive të Arsimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar: për përpilim të padisë shumë prej 104 Euro, për një seancë të mbajtur gjyqësore, shumë prej 135 Euro dhe për taksë gjyqësore, shumë prej 21 Euro.

E paditura, në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke e cilësuar si të pa bazuar në ligj, për faktin se DKA-Komuna e Vitisë nuk është përgjegjëse për moszbatimin e kontratës kolektive të vitit 2017, të cilën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe SBASHK, dhe nuk kanë ndarë mjete buxhetore për kompensimin e këtyre beneficioneve që dalin nga Kontrata Kolektive, andaj edhe ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e paditësës ta refuzoj si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Kërkesa drejtuar DKA-së me post rekomande, e datës 07.12.2019, Kontrata e punës nr.05-207/2018, e dt.01.09.2018, Vërtetimi nga SHFMU "Njazi Rexhepi", me nr.454, i datës 30.04.2021, Vërtetimi nga SHFMU "Halil Alidema", me numër 223, i dt.06.05.2021, Lista e pagave EM 00123562, Vërtetimi nga NT "Shpresimi", i datës 05.05.2021.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësës N.N.është pjesërisht e bazuar, dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Nga provat materiale të administruara gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike; Paditësja Ardiana Musa, fillimisht nga data 01.09.2010 deri më 31.08.2018, ka qenë e punësuar në SHFMU "Njazi Rexhepi" në fshatin N.N, e cila ka gjithsej 8 vite përvojë pune, ndërsa tani është në marrëdhënie pune – mësimdhënëse në SHFMU "Halil Alidema" në fshatin Pozheran prej datës 01.09.2018, vazhdon të punoj në këtë institucion dhe tani ka gjithsej 10 vite përvojë pune, ndërsa paga bazë e paditësës është 421 Euro.

Faktin se paditësja, fillimisht, ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura, në SHFMU "Njazi Rexhepi", në fshatin N.N, gjykata e vërtetoi në bazë të vërtetimit me nr.454, i datës 30.04.2021, sipas të cilit, paditësja kishte themeluar marrëdhënie të punës në këtë institucion nga data 01.09.2010 dhe kishte punuar deri më 31.08.2018, dhe për këtë periudhë ka qenë e pranishme në punë 266 ditë. Fakti se paditësja me datë 01.09.2018 e ka filluar marrëdhënien e punës në SHFMU "Halil Alidema" ku ende vazhdon të punoj, u vërtetua me vërtetimin nr. 223, të datës 06.05.2021, dhe tani përvoja e paditësës është 10 vite, ndërsa për periudhën prej 01.09.2018 deri me 17.04.2021, ka qenë e pranishme në punë 488 ditë. Paga bazë e paditësës në shumë prej 421

Euro, u vërtetua në bazë të Regjistrimit të pagave, sipas të cilit paditësja është anëtare e SBASHK-ut dhe për këtë paguan anëtarësi.

Meqenëse në bazë të provave të administruara u vërtetua gjendja faktike si më lart, gjykata e obligoi të paditurën që paditëses, t'ia kompensojë shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes për kompensimin e ushqimit, gjykata u bazua në nenin 35 pika 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, i cili ka paraparë kompensimin e ushqimit në punë nga 2 Euro për një ditë pune. Ndërsa për shpërblimin jubilar gjykata u bazua në nenin 35 par. 8, pika 8.2 të Kontratës Kolektive, i cili ka paraparë “punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: [...] për 10 vjet të përvojës së punës, në vlerë të 50% të një page bazë [...]”.

Gjykata, me qëllim të zbatimit të parimit të ekonomizimit të procedurës, nuk caktoi ekspert financiar për faktin se e paditura nuk pati vërejtje në provat e administruara, andaj, llogaritja e shumave është bërë sipas përlllogaritjes së thjesht matematikore.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës, të cilat u gjetën si të pa bazuara, për shkak se palët kontraktuese të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK)), në nenin 2 të kësaj Kontrate kanë përcaktuar: “Dispozitat e këtij Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”. Për më tepër, nenin 37 kanë përcaktuar se “palët nënshkruese të këtij kontrate kolektive janë të obliguara që të zbatojnë dhe t'i respektojnë dispozitat e kësaj kontrate”.

Sa i përket periudhës së aprovuar të kërkesave të paditëses pas datës 18.04.2020 deri me 17.04. 2021, gjykata konsideron se Kontrata Kolektive zbatohet edhe për këtë periudhë, për shkak se sipas nenit 45 të Kontratës Kolektive është përcaktuar “[...] nëse nga kontrata kolektive pasi t'i skadojë afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit [...]”. Kontrata Kolektive ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa nuk ka dëshmi se ndonjëra nga palët kontraktuese, është tërhequr.

Gjykata e refuzoi pjesën tjetër të kërkesës për shpërblimin jubilar për shkak se paga bazë e paditëses është 421 Euro, ndërsa, për shpërblim jubilar i takon 50 % e pagës bazë, e që sipas llogaritjes së thjeshtë i takon shuma prej 210.50 Euro, e jo shuma prej 423 Euro. Ndërsa, sa i përket refuzimit të kërkesës për kompensimin e ushqimit prej datës 18.04.2021 deri me datë 06.05.2021, gjykata u bazua në faktin se sipas nenit 45, Kontrata Kolektive, për shkak se asnjëra nga palët nuk është tërhequr, me automatizëm është vazhduar për një vit, ndërsa përfundimisht ka skaduar me datë 17.04.2021. Për këtë arsye, pjesa e kërkesës për kompensimin e ushqimit prej datës 18.04.2021 deri me 06.05.2021 u refuzua si e pa bazuar në ligj. Gjithashtu, shuma totale e kërkesës për pagimin e shpenzimeve të ushqimit nuk ishte në përputhje me ditët e pranisë së paditëses në punë, e cila po ashtu u refuzua si e pa bazuar në ligj.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që e paditura e ka humbur kontestin në këtë rast, andaj edhe obligoi të njëjtën që paditësit t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 270 Euro edhe atë: për përpilimin e padisë 104 Euro, për taksë gjyqësore 31 Euro si dhe për një seancë gjyqësore 135 Euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifat e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr. 679/2019, datë 07.05.2021

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.